REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1129/20
Datë/Datum. 22.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: ***Kuvendi Komunal i Podujevës***

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: (61520141121) nr. i brendshëm:615-20-7524-1-2-1

Sa i përket tenderit për**Furnizim dhe mbletim të drunjeve dekorativ në sheshin e qytetit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

(N.T BITI - COM)

(F.SH LUPQ I POSHTEM)

(PODUJEVE) *(11000)*

(044875608)(Numri i Faks-it)

(BERAT KAQIU)

(LULISHTJABITI@HOTMAIL.COM)

(21.12.2020) *(Nënshkrimi dhe vula)*

BITI - COM N.T PODUJEVË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit",nëse aplikohet, afatin e fundit per dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Data e publikimit: 13.11.2020, vendi i publikimit E-prokurimi
- Data e Njoftimi për dhënje.07.12.2020
- Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve, datë: 26.11.2020
- Data e hapjes së tenderëve .26.11.2020, Ora:13:0:00
- Kriteri per dhenje te kontrates : çmimi me i ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Vetem ne menyre elektronike permes E-PROKURIMIT

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apoNjoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. **QëllimiNeni1.** Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase,më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike.

2. **Neni.6** Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publik edhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike,njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

3. **Neni.7 BarazianëTrajtim/Jo-Diskriminimi,** Autoriteti kontraktues do ti trajtojo peratorët ekonomiknë mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

4. Rregullat per Tenderet Jo-Normalisht te Ulet_v2_07_07_2016 (1).Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët neni Neni 3, Informatat e përgjithshme

5. **Llogaritjae VlerëssëParashikuartëKontratëspër Furnizim Neni16**

   Vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për furnizim duhet të jetë e barabartë me çmimin përfundimtar që duhet të paguhet nga autoriteti kontraktues për të gjitha produktet, shërbimet dhe objektet e tjera që përfshihen në një kontratë të tillë.

6. **Neni 59.Ekzaminimi,Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,** Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm në se tenderinë fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesate parashtruaranë njoftimine kontratës dhe në dosjen e tenderit.

7. **Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të UlëtProcedura e shqyrtimit** ***(inter partes)***

Neni 4. pika, 4.4.4 origjinalitetin efurnizimeve,shërbimeve,punës ose punëvetëpropozuara.

- **Përveç elementeve te tenderit te përcaktuara ne nenin 4.4 te këtyre rregullave, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:**

4.5.1 elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet.

8. **Dëshmi**-Hulumtimi i tregut nga ne si OE ankues, duke ofruar fakte oferta **(me çmime reale të tregut)** dhe duke argumentuar se AK-Kuvendi Komunal i Podujevës ka marrë vendim të kundërligjshëm.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5.000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. **QëllimiNeni1.** Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase,më transparent edhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike.

1.1 AK, nuk ka ofruar siguri për konkurencë të mirëfilltë në mes të operatorëve ekonomik, vlenë të theksohet në Njoftimin e Vendimit të Autoritetit Kontraktues se përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues është në kundërshtim me nenin .1. pasi që fondet publike janë në disproporcion të madhë/ekstrem me vlerën e parashikuar të kontratës me vlerën e ofertës të OE, të shpërblyer me kontratë.

Sqarim: Vlera e parashikuar e kontraës është:**40 500,00 €**, ndërsa vlera e ofertës e OE, të rekomanduar për kontratë nga AK është **12,300.00** €, me një diferencë/ndryshim prej **28,200.00 €**. Me këtë vërtetohet se AK, nuk ka bërë analizë të mirëfilltë të vlerës së parashikuar të kontratës, dhe se vlera reale e tregut për këtë aktivitet të prokurimit është ajo e cila do të sqarojmë me rregullat mbi çmimet abnormalisht të ulëta dhe ofertat konkuruese në këtë procedurë.

2. **Neni.6** Tëgjithaautoritetetkontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publik edhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike,një kohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndë ne prokurimit.

2.1. Vendimi i marrë nga ana juaj si AK, shpërfillë dhe është në kundërshtim të

2.1. Vendimi i marrë nga ana juaj si AK, shpërfillë dhe është në kundërshtim të plotë me të gjitha elementet e **nenit 6.** për të siguruar se fondet publike janë duke u perdorur në **mënyrë ekonomike** dhe është në **harmoni me qëllimin e kontratës**. Propozimi i OE, për shpërblim me kontratë, është një devijim i çmimit nga çmimet reale të tregut, pothuajse një mashtrim nga AK, me vlerën e parashikuar të kontratës e ku në esencë mund të kuptohet një bashkpunim i AK me OE, dhe kurdisje e ofertës me të cilën ka verpruar ti eliminon**OE me çmime normale-reale të tregut**, këtë do të vërtetojmë edhe me elementet përbërse të çmimeve ku do të ofrojmë dëshmi se OE fitues ka ofruar çmime manipulative dhe ka prishur konkurencën e mirëfilltë në treg, në bashkpunim me AK.

3. **Neni.7 BarazianëTrajtim/Jo-Diskriminimi,** Autoriteti kontraktues do titrajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

3.1. Ne si OE, konstatojmë se Vendimi juaj është diskrimues për ne, dhe jemi trajtuar në mënyrë të pabarabart në raport me operatorin ekonomik fitues saktesisht te kriteri: (kriteri i përzgjedhjes cmimi me i ulët) duke i'u referuar çmimit të ofertave konkuruese dhe duke eliminur te gjitha mundësit për një transaprencë në mes të operatorëve ekonomik po ashtu duke mos e apikuar, rregullat për çmime abnormalisht të ulët.

4. Rregullat per Tenderet Jo-Normalisht te Ulet_v2_07_07_2016 (1).Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët neni Neni 3, Informatat e përgjithshme

Neni 3
Informatat e përgjithshme

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen te **gjitha kushtet e mëposhtme:**

i. çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve** të përgjegjshëm;
ii. çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët**;
iii. **janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.**

Nr.				
	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë 3 oferta	Pranuar 3 oferta		
2		1	36,500.00	
3		2	12,300.00	
4		3	22,750.00	
5		Total (C2+C3+C4+)	71,550.00	
6		mesatarja (C8/3)	23,850.00	
10	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /1.3)	18,346.15	ne ketë rast vetëm oferta 2 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete

11	**kushti 3** – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	pragu 10% (oferta e dyte /1.1)	20,475.00	ne ketë rast oferta 2 përmbush edhe kushtin e trete

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se **3 oferta**	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 3 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve** të përgjegjshëm	Oferta e dyte plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët**	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih pragun C11
Konkludim	Oferta me nr. rendor 2 plotëson 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet	

Shënim:
Siç mund të shihet edhe nga rasti shembull i zbatuar, në bazë të rregullores për trajtimin e çmimeve abnormalisht të ulëta vertetohet se Oferta e operatorit ekonomik " Lulishta Buçaj" duhet të refuzohet/anulohet nga Autoriteti Kontraktues, pasi që plotëson të gjitha kriteret për eliminim me kushtet e përcaktuara me legjislacioniin primar dhe sekondar të prokurimit publik.

5.Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Furnizim Neni 16.

Vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për furnizim duhet të jetë e barabartë me çmimin përfundimtar që duhet të paguhet nga autoriteti kontraktues për të gjitha produktet, shërbimet dhe objektet e tjera që përfshihen në një kontratë të tillë. Llogaritja/përllogaritja-kalkulimi i vlerës së parashikuar, duhet të bëhet nga kontratat paraprake të natyrës së njëjtë, enti i statistikave apo nga ndonjë organ publik kompetent –zyrtar. Me ofertën e shpallur fitues të kontratës me një çmim të cilin nuk i mbulon as elementet thelbësore të produktit AK ka bërë shkelje të cilat kanë shkaktuar dëme ligjore dhe materiale duke mos e analizuar Vendimin dhe harmonizuar me bazën ligjore për prokurim publik. Andaj shkelja e neni 16. të LPP, nga AK, ka bërë diskriminim në mes të OE, konkurues dhe ka favorizuar OE. duke bërë shkelje flagrante të LPP

5.Neni 59.Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Duke u bazuar në vlerësimin e Ofertave nga AK, AK ka bërë shkleje edhe të nenit përkatës 59. Duke mos bërë ekzamimin, vlersim dhe krahasim të ofertave në bazë të rregulllave të cilat parashihet në Legjislacionin primar dhe sekondar për prokurim publik.

9. **Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të UlëtProcedura e shqyrtimit *(inter partes)***

- **Neni 4. pika, 4.4.4 origjinalitetin efurnizimeve,shërbimeve,punës ose punëvetëpropozuara.**

- **Përveç elementeve te tenderit te përcaktuara ne nenin 4.4 te këtyre rregullave, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:**

4.5.2 elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet.

AK-Kuvendi Komunal i Podujevës, nuk ka përfillë asnjërin nga nenet e lartëcekura siç, mund të shihet edhe në kërkesën për sqarim nga OE, të rekomanduar si fitues, për çmime abnormalisht të ulëta.

Andaj AK-Kuvendi Komnual i Podujevës ka bërë shkelje të **vullnetshme me vetëdije të plotë dhe (jo-profesionale)** të neneve të lartëpërmendura, ku ne si OE ankues u'a dëshmojmë-vertetojmë me faktet e bashkangjitura.

7.Dëshmi-Hulumtimi i tregut nga ne si OE ankues, duke ofruar fakte oferta **(me çmime reale të tregut)** dhe duke argumentuar se AK-Kuvendi Komunal i Podujevës ka marrë vendim të kundërligjshëm.

*7.1.*Se Autoriteti Kontraktues, Kuvendi Komunal i Podujevës ka shkelur LPP, në nenet e lartëpërmendura e vertetojnë edhe Ofertat të cilat i kemi siguruar me rastin e hulumtimit të tregut e të cilat të njëjtat mund të verifikohen nga secili organ ose zyrtar i cili shpreh interesim, në adresat të cilat i keni të bashkangjitura me oferta.

- Hulumtimi i tregut dhe sigurimi i ofertave për çmimr abnormalisht të ulëta është dashur të bëhet nga vetë AK, mirëpo e kemi marrë si barrë ne si OE, për të vertetuar shkeljet dhe parregullësitë të cilat kanë ndodhur nga AK-Kuvendi Komunal i Podujevës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet mund të jenë të pariparuara për ne si OE, pasi që vendimet e tilla për ne si OE na krijon barriera ligjore të qëllimshme të cilat edhe mund të na shtyej në mbylljen e biznesit familjar nga vetë Institucionet të cilat në një mënyrë janë të obliguara të na përkrahin në mënyrë ligjore dhe jo të na bëjnë padrejtësi të cilat na diskrimionojnë në raport me OE konkurues dhe vetë LPP.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve. nëse aplikohet.

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

h) Ofertat-Hulumtimi i tregut (dy oferta origjinal).

****Sipas Nenit 111.2 të LPP,Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*